

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr: 623 REGJ. THEMELTAR
Dt. Rregjistrimi: 27.03.2023

Nr. 1416/2 Vendimi
Dt. Vendimi: 28.04.2023

V E N D I M
“I GJYQTARIT TË VETËM”

Në Tiranë, sot më datë 28.04.2023, unë gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë **Ervin Pollozhani**, pasi studiova kërkesën dhe materialet e paraqitura nga Zj. Klodiana Kapo, me cilësinë e Drejtoreshes Ekzekutive të Qendrës “Faktoje”,

KONSTATOVA:

Se, Qendra “Faktoje” është regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. 1416 dt. 30.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në vijimësi të veprimtarisë së saj, më datë 17.03.2023 është zhvilluar mbledhja e Bordit Drejtues, me pjesëmarrjen e anëtarëve: Erjon Tase, Llazar Semini, Elizabeth Gowing dhe Estela Koçi. Rendi i ditës së mbledhjes ka qenë:

- *Pranimin e kërkesës për dorëheqje për arsye personale të anëtrit të Bordit Dorian Matlija.*

Në këtë mënyrë, anëtarët e Bordit Drejtues, kanë marrë Vendimin datë 17.03.2023, në bazë të të cilit në mënyrë unanime kanë vendosur:

- *Largimin për arsye personale të anëtarit të Bordit z. Dorian Matlija.*

Pikërisht këtë vendim të marrë, të pasqyruar formalisht, përfaqësuesja e Qendrës, kërkon që ta depozitojë pranë regjistrimit të OJF-ve me qëllim dhënien e efekteve ligjore të tij.

Pasi studiova kërkesën dhe vendimin e sipërpërmendur si dhe praktikën e akteve të regjistrimit të kësaj qendre, gjykata e gjeti këtë kërkesë të saj të drejtë, të bazuar në ligj dhe në statut dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të Ligjit Nr. 8788 datë 07.05.2001 dhe Ligjit Nr. 8789 date 07.05.2001, si dhe dispozitave të Kodit Civil,

VENDOSA:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e Vendimit datë 17.03.2023 të Bordit Drejtues të Qendrës “Faktoje”, në bazë të të cilit është vendosur:

- *Largimin për arsye personale të anëtarit të Bordit z. Dorian Matlija.*

3. Urdhërohet, Zyra e Regjistrimit të OJF-ve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të kryej veprimet përkatëse për regjistrimin e këtij vendimi.

4. Tiranë më datë 28.04.2023!

GJYQTAR

ERVIN POLLOZHANI



Tabela e shpenzimeve

<u>Taksë regjistrimi</u>	1000 lekë
<u>Totali</u>	1000 lekë